

RELACION

PËR

PROJEKVENDIMIN

PËR

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR
MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË
TRAFIKIMIT**

**I. QËLLIMI I PROJEKVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 10.07.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe Planin e Veprimit 2023–2025”, të ndryshuar”, duke shfuqizuar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.08.2018 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen e viktimave të trafikimit kanë për qëllim të ofrojnë një kuadër të qartë, të harmonizuar dhe funksional për të gjitha hallkat institucionale shtetërore dhe jo-shtetërore të përfshira në trajtimin e këtij fenomeni kompleks dhe të ndjeshëm.

Ato përcaktojnë hapat që duhen ndjekur dhe ndarjen e qartë të përgjegjësiave ndërmjet aktorëve të përfshirë në të gjitha fazat e procesit – nga identifikimi fillestar i një rasti të mundshëm, deri te mbështetja afatgjatë dhe riintegrimi i viktimës në shoqëri.

Këto procedura janë ndërtuar mbi parimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe vendosin në qendër të veprimit viktimën, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe moshës, si dhe të përshtatur me nevojat individuale të çdo rasti. Ato synojnë jo vetëm parandalimin e trafikimit, por edhe një përgjigje efektive dhe të koordinuar për identifikimin, mbrojtjen, asistencën, kthimin vullnetar të asistuar dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme – pavarësisht nëse janë shtetas shqiptarë apo të huaj,

dhe pavarësisht nëse janë të identifikuar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Procedurat i përgjigjen nevojës për një sistem të qëndrueshëm institucional, i cili garanton që asnjë viktimë apo viktme e mundshme të mos mbetet pa trajtuar, dhe që çdo institucion të veprojë në mënyrë të koordinuar dhe të standardizuar, pa mbivendosje apo boshllëqe në përgjegjësi.

Në të njëjtën kohë, PSV-të përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në përafrimin e kuadrit rregullator dhe praktikës shqiptare me standardet e Bashkimit Evropian, si dhe me rekomandimet e vazhdueshme të raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë vlerësuar reagimin institucional ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri. Në përmbajtjen dhe strukturën e tyre, procedurat marrin në konsideratë nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të mekanizmave ekzistues, sidomos në drejtim të kapaciteteve për identifikimin formal, hetimin, ndihmën psiko-sociale, ndjekjen penale të autorëve dhe mbështetjen për viktimat në rrugën drejt një jete të re dhe të sigurt.

Në këtë kontekst, PSV-të janë konceptuar si një instrument praktik, dokument referues ligjor dhe udhërrëfyes operacional për të gjitha institucionet që janë pjesë e mekanizmit kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore – përfshirë Policinë e Shtetit, shërbimet sociale rajonale dhe lokale, shërbimet e punësimit dhe aftësimit profesional, autoritetet vendore, institucionet arsimore dhe shëndetësore, si dhe organizatat joqeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë.

Zbatimi efektiv i këtyre procedurave është një kusht thelbësor për garantimin e mbrojtjes së plotë dhe të qëndrueshme të viktimave të trafikimit, për rritjen e efikasitetit institucional dhe për forcimin e besimit të viktimave në institucionet shqiptare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, është planifikuar në 4 mujorin e III, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për vitin 2025 për Ministrinë e Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ministria e Brendshme, vlerëson si të domosdoshëm miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit pasi nëpërmjet këtyre procedurave:

Relacion shpjegues për projektvendimin për “Miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

- Përcaktohen qartë indikatorët për të rriturit dhe fëmijët, format e shfrytëzimit, dhe institucionet përgjegjëse për identifikimin fillestar dhe formal.
- I kushtohet një rëndësi specifike intervistimit dhe kushteve për zhvillimin të tij, përfshirë mbështetjen afatgjatë dhe riintegrimin social-ekonomik të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, aspekt që ka munguar në PSV-të aktuale;
- Anëtarët respektivë të Autoritetit Përgjegjës do të kenë detyra të qarta dhe specifike për secilin nga hapat;
- Dokumenti është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, si Ligji për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, etj.

Parashikohen formatet e dokumentimit dhe procesi i monitorimit, si dhe theksohet ngritja e një Komisioni të Posaçëm Ndërinstitucional për shqyrtimin e ankimeve, çka përbën risi krahasuar me dokumentin aktual; Për herë të parë parashikohet njohja me vendim e statusit të viktimës dhe viktimës së mundshme të trafikimit, për të dyja kategoritë, dhe jo vetëm për viktimat e mundshme. Këto procedura zbërthejnë dhe qartësojnë akoma më tej rolin, detyrat dhe përgjegjësitë që kanë të gjitha institucionet dhe agjencitë e përfshira në procesin e identifikimit dhe referimit të viktimave të trafikimit.

Procedurat përfshijnë të gjitha veprimet e kryera nga punonjës të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore dhe joshtetërore-anëtare të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare jo anëtare të MKR-së me/pa programe për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për pritjen, identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe ndihmën për rehabilitimin dhe ri-integrimin e sigurt të personave të trafikuar në përputhje me këto procedura.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektvendimi “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, gjen mbështetje në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002, “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj”, si dhe në ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

Relacion shpjegues për projektvendimin për “Miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

Gjithashtu, Procedurat Standarde bazohen në eksperiencën e deritanishme në zbatim të:

- Vendimit Nr. 499, datë 29.08.2018 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Procedurave Standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”;

- Detyrimeve që rrjedhin nga “Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave”, rishikuar në vitin 2023; nga udhëzimi i përbashkët nr.132, datë 08.09.2023 “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ri integrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”; nga Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë”.

Po ashtu, Procedurat janë hartuar në të njëjtën frymë me instrumentet ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e parandalimit të trafikimit, mbrojtjes së personave të trafikuar dhe ndjekjes penale të trafikantëve, dhe reflektojnë rekomandimet e dhëna për të njëjtën fushë veprimi nga organizma ndërkombëtarë, si OKB, DASH, KiE, OSBE, etj.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektvendimi *përafrohet pjesërisht* me Direktivën 1712/2024 që ndryshon Direktivën 2011/36/BE “Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit përcaktojnë hapat për mbrojtjen në kohën dhe mënyrën e duhur të personave të trafikuar, në rrezik trafikimi, të rritur apo të mitur, për të gjithë llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

Fokusi kryesor i këtyre procedurave është viktimat dhe mbrojtja e saj, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe duke ndërtuar standarde të unifikuara për mënyrën se si do të zhvillohet i gjithë procesi i identifikimit, referimit dhe më pas i mbrojtjes së viktimës së trafikimit. Duhet theksuar se, këto procedura zbatohen

Relacion shpjegues për projektvendimin për “Miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

për të gjitha kategoritë e viktimave/viktimave të mundshme (të mitur dhe të rritur, femra dhe meshkuj, shqiptarë dhe të huaj) që janë subjekt i trafikimit për të gjitha llojet e shfrytëzimit.

Në mënyrë të detajuar parashikohen:

- treguesit, hapat që duhet të ndjekin punonjësit e vijës së parë për identifikimin dhe reagimin formal të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit;
- veprimet që duhet të ndërmarrin për intervistimin e fëmijës ose të rriturit;
- strukturat e intervistimit për fëmijë dhe të rritur; dokumentimi sipas formateve standarde;
- e drejta për ankimim dhe krijimi i Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional;
- masat emergjente dhe vendosja e fëmijës ose të rriturit në strehëza;
- kthimi vullnetar i asistuar dhe pritja e personave të trafikuar me shtetësi shqiptare;
- mbështetja e hetimit dhe dënimit të trafikantëve;
- mbështetja afatgjatë dhe riintegrimi social-ekonomik i viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit;
- formatet për zbatimin e procedurave standarde.

Procedurat parashikojnë situata në të cilat vendi ynë, apo zona të caktuara të vendit, përdoren, apo mund të përdoren si vend origjine, tranziti ose destinacioni për lëvizjen dhe shfrytëzimin e personave të trafikuar shqiptarë dhe të huaj, si edhe situata në të cilat personat e trafikuar me shtetësi shqiptare, apo të hamendësuar shqiptare ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Procedurat nënkuptojnë ndërhyrje të specializuar sektoriale dhe ndërsektoriale/multidisiplinare dhe zbatimin e tyre është detyrim për të gjitha institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor që veprojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo janë me mision shtetëror jashtë vendit, si dhe parashikojnë bashkëpunimin me strukturat homologe të shteteve të huaja.

Gjithashtu, zbatimi i Procedurave Standarde është i detyrueshëm edhe për agjencitë joshetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në çdo moment në të cilin ato, gjatë veprimtarisë së tyre, bien në

kontakt me një person që dyshojnë se mund të jetë trafikuar apo kanë informacion se është person i trafikuar.

Megjithëse është fryt i përpjekjeve të bashkërenduara të qeverisë, organizatave shërbim ofruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, përgjegjësia për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit është e institucioneve shtetërore.

Identifikimi dhe referimi për ndihmë i personave të trafikuar bëhet në bashkërendim dhe bashkëpunim të plotë të të gjitha autoriteteve dhe strukturave shtetërore dhe joshtetërore.

Kthimi vullnetar i asistuar për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit do të mundësohet dhe garantohet nga vendi i origjinës dhe i destinacionit, duke bërë vlerësimin e situatës së personave në vendin dhe familjen e origjinës para kthimit dhe marrjen e vendimit të kthimit në interesin më të lartë të tyre, duke u bazuar në raportin për vlerësimin e situatës familjare dhe rrezikut para kthimit, si dhe në autorizimin e prindit/kujdestarit për kthim të asistuar të fëmijës.

Pjesëmarrja e organizatave shërbim ofruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit dhe e shoqërisë civile është e domosdoshme për arritjen e synimeve të Procedurave Standarde të Veprimit, d.m.th. mbrojtjen, parandalimin dhe ndihmën ndaj viktimave të këtij krimi.

Procedurat ruajnë ato elementë të vlerësuar si pikat më të forta në luftën kundër trafikimit duke u përditësuar njëkohësisht me një qasje të re në përputhje të nevojave dhe kontekstin aktual. Në këtë dokument janë ruajtur elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me gjithë përfshirjen e agjencive shtetërore dhe joshtetërore, si dhe shtrirjen e veprimit të tij në të gjithë territorin e vendit, duke e vënë theksin sërish në forcimin e kapaciteteve dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

VIII. MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi u hartua nga Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP), ngritur me Urdhrin nr. 243, datë 24.12.2024 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për rishikimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.499, datë 29.08.2018 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”. Për hartimin e këtij dokumenti janë organizuar tre takime të GNP-së, konkretisht: më datë 8 prill, 23 prill dhe 19-20 maj. Gjatë takimeve, anëtarët e GNP-së dhanë mendime dhe sugjerime mbi draftin, të cilat janë reflektuar në dokument. Pas takimit dyditor (19-20 maj), drafti u dërgua për komente finale grupit të punës dhe më pas u përcoll pranë Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator për vlerësim dhe dërgimin e praktikës për mendim pranë ministrive të linjës.

Ministria e Financave nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord, duke kërkuar që efektet financiare të projektvendimit të përballohen brenda tavaneve buxhetore të miratuara për institucionet e ngarkuara me zbatimin e tij.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, nëpërmjet sistemit e-Akte shprehet parimisht dakord, duke sugjeruar:

- “Ky projektakt lidhet me aspekte që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe prandaj në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore, duhet t’i nënshtrohet konsultimit me ato në Këshillin Konsultativ”, sqarojmë se, **projektvendimi u përcoll pranë Këshillit Konsultativ dhe më datë 21.07.2025 u diskutua dhe miratua pa komente.**
- Në pikën 3 të projektvendimit ngarkohet për zbatimin e tij ndër të tjera Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe jo njësitë e vetëqeverisjes vendore që do të duhet të zbatojnë procedurat standarde në përditshmëri në terren. Për sa më sipër, sugjerojmë përfshirjen e njësive si subjekte që ngarkohen me zbatimin e projektaktit dhe heqjen e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, **sqarojmë se u reflektua.**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet sistemit e-Akte shprehet parimisht dakord, duke sugjeruar:

- Në faqen 8, të dokumentit të procedurave, tek parimet e përgjithshme, në pjesën mbi identifikimin dhe reagimin fillestar, togfjalëshi “*shkollat dhe institucionet arsimore*” të zëvendësohet me togfjalëshin “institucione arsimore”, në kushtet që shkollat janë lloj i institucioneve arsimore. Ky sugjerim të mbahet në konsideratë për unifikim në përmbajtjen e të gjithë dokumentacionit të përcjellë, **sqarojmë se u reflektua.**
- Lidhur me....togfjalëshi “*Ministria e Arsimit dhe Sporteve*” të zëvendësohet me togfjalëshin “Ministria e Arsimit dhe Sportit”... **sqarojmë se u reflektua.**
- Lidhur me...togfjalëshi “*Arsimi 9-vjeçar*” të zëvendësohet me termin “*arsimi bazë*” në përputhje me terminologjinë e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky sugjerim të reflektohet edhe në përmbajtje të të gjithë dokumentacionit. Gjithashtu, në faqen 69 dhe 72 të draftit, togfjalëshi “*Arsimi i mesëm*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*Arsimi i mesëm i lartë*”, **sqarojmë se u reflektua.**

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet sistemit e-Akte shprehet si më poshtë:

1. Në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe Planin e Veprimit 2023–2025”, i ndryshuar, parashikohet si masë prioritare rishikimi i vendimit nr. 499, datë 29.8.2018, të Këshillit të Ministrave. Në vijim, në vendimin nr. 818, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025”, parashikohet miratimi i aktit “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.499, datë 29.08.2018 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit””. Sa më sipër, sugjerojmë që rregullimet e synuara me projektvendimin e përcjellë për mendim të bëhen me një akt ndryshues të vendimit në fuqi dhe jo duke e shfuqizuar atë. Lidhur me sugjerimin vlerësojmë se duhet të shfuqizohet akti ekzistues pasi, projektakti i propozuar ka prodhuar risi në formën përmbajtësore të tij. Konkretisht:
- parashikimi i vendimit për njohjen e statusit të viktimës dhe viktimës së mundshme të trafikimit, i cili nuk ka qenë parashikuar në VKM nr.499, datë 29.08.2018;
- parashikimi i ngritjes së Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional, si organ epror që shqyrton ankimin administrativ të paraqitur ndaj vendimit të dhënë nga grupi i identifikimit formal, në rast të mosdakordësisë me vendimin e dhënë;

- ndryshime thelbësore janë reflektuar edhe në formatet e intervistës fillestare dhe formale për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit;
 - janë parashikuar treguesit për të rriturit dhe tregues për të miturit dhe brenda këtyre kategorive janë përfshirë edhe nënkategoritë e treguesve për të huajt, duke pasur parasysh praninë në rritje të të huajve në Shqipëri, kryesisht për qëllime punësimi.
 - janë parashikuar kushtet për zhvillimin e intervistës, duke garantuar pjesëmarrjen dhe konfidencialitetin e përkthyesit (në rastet kur intervistohet një person i huaj);
 - janë parashikuar treguesit dhe indikatorët për shfrytëzimin për puën të detyruar, lypje dhe krime të vogla;
 - është parashikuar pjesëmarrja e personave të tretë në intervistë, kushtet e intervistimit, kohëzgjatja dhe informimi i intervistuesit mbi të drejtat e tij;
 - parashikohen procedura në lidhje me masat emergjente për fëmijët, akomodimi i fëmijëve dhe të rriturve në qendrat e emergjencës, në strehëz;
 - regjistrimi i fëmijëve në gjendjen civile është risi dhe adresim i një problematike të evidentuar gjatë zbatimit të PSV-ve aktual;
 - Mbështetja afatgjatë dhe riintegrimi socio-ekonomik i viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, e parashikuar në projektakt, do të mundësojë riintegrimin e tyre në shoqëri e cila sjell edhe mosviktimizimin e tyre dhe ndalimin e ritrafikimit;
 - Qasja e re dhe inovative reflektohet e dhe tek formatet e dokumentimit që janë parashikuar në projektakt, në ndryshim nga ato ekzistuese që janë një numër i konsiderueshëm dhe, në shumicën e tyre të paaplikueshëm;
 - Vlen të theksohet fakti që, këto procedura janë hartuar edhe “në dritën” e Direktivës 1712/2024 që ndryshon Direktivën 2011/36/BE “Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij”;
- Gjithashtu, projektakti është hartuar duke pasur parasysh gjetjet, problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të procedurave ekzistuese dhe problematikave të adresuara për zgjidhje në Autoritet Përgjegjës.

2. Sa i takon përkufizimeve sugjerojmë të shtohet termi “*person i besuar*” që në kuptim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, është personi madhor i kërkuar nga i mituri dhe i pranuar nga organi kompetent, i cili shoqëron të miturin në fazat e procedimit penal. Gjithashtu përkufizimi “*prind*” sugjerojmë të jetë i harmonizuar dhe në përputhje me paragrafin 16, të nenit 3, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili e përkufizon “*përfaqësuesin ligjor*” si prindi, i afërmi ose kujdestari i të miturit, i cili merr pjesë në procedurën e drejtësisë penale për të mitur për të mbrojtur interesat e të miturit. **Sqarojmë se, u përfshi termi “*person i besuar*” tek përkufizimet.** Lidhur me sugjerimin, që përkufizimi “*prind*” sugjerojmë

të jetë i harmonizuar dhe në përputhje me paragrafin 16, të nenit 3, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, **sqarojmë se përkufizimi i përdorur në teksti referohet përkufizimit të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.**

3. Në përmbajtje të projektvendimit, sa i takon vlerësimin të situatës, sugjerojmë të shtohet edhe vlerësimi i situatës psikologjike, krahas asaj shëndetësore, me qëllim dhënien e ndihmës psikologjike apo edhe këshillimet/shërbimet e mundshme që mund të ofrohen nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale, bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, **sqarojmë se u reflektua.**
4. Në përcaktimin e procedurave standarde që duhet të ndiqen për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, sugjerojmë që intervista të zhvillohet edhe në praninë e mbrojtësit dhe kur është rasti, personat të mund të përfitojë ndihmë juridike parësore me qëllim garantimin e të drejtave procedurale dhe ruajtjen e interesave ligjore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se u reflektua.**
5. Lidhur me kushtet për zhvillimin e intervistës, sugjerojmë të parashikohet parimi i ndalimit të zhvillimit të intervistës 2 herë për të njëjtin fakt për të miturin, me qëllim shmangien e rëndimit të gjendjes psikologjike të tij, **sqarojmë se u reflektua.**
6. Në këtë projektvendim është parashikuar krijimi i Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional, si organ epror që shqyrton ankimin administrativ të paraqitur ndaj vendimit të dhënë nga grupi i identifikimit formal. Ky Komision parashikohet të jetë i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfshirë këtu dhe Ministrinë e Drejtësisë. Në këtë kuadër, sugjerojmë të përcaktohen kompetencat dhe detyrat funksionale, si dhe roli që duhet të ketë anëtari i Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional, **sqarojmë se u reflektua.**
7. Lidhur me pjesën që përshkruan mbështetjen afatgjatë dhe ri/integrimin social ekonomik, sugjerojmë që termi “zyrat e këshillimit ligjor falas” të zëvendësohet me termin “qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore”, bazuar në shkronjën “d”, të nenit 3, të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, **sqarojmë se u reflektua.**

8. Në Kreun IV, të relacionit shpjegues, sugjerojmë heqjen e paragrafit të parë nga përmbajtja e tij, pasi nuk është në përputhje me parashikimin e bërë në projektvendim dhe nuk shërben si bazë ligjore për miratimin e tij. Gjithashtu, në Kreun V, sugjerojmë që termi “*projekturdhri*” të zëvendësohet me termin “*projektvendimi*”. Në vijim, sa i takon Kreut VII të relacionit, që parashikon institucionet dhe organet e ngarkuara me zbatimin e projektvendimit, sugjerojmë rishikimin e tyre në përputhje me pikën 3 të projektvendimit, me qëllim që këto dy parashikime të jenë në përputhje me njëra- tjetrën. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se u reflektua.**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord, duke sugjeruar:

- Në pikën 3, të projektvendimit, konstatojmë se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ngarkohet për zbatimin e vendimit, ndërkohë që në materialin bashkëlidhur projektvendimit nuk ka detyra konkrete për ministrinë, për më tepër që edhe në Kreun VII, të relacionit shoqërues, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk citohet si institucion për zbatimin e këtij vendimi. Për rrjedhojë, sugjerojmë rishikimin e pikës 3 të projektvendimit. Lidhur me këtë sugjerim, sqarojmë se u reflektua.
- Lidhur me sugjerimin....termi “*hotel*” të zëvendësohet me termin “*strukturë akomoduese*”, **sqarojmë se u reflektua.**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet si më poshtë:

1. Në Parimet e Përgjithshme, paragrafi: “*Ndihmë ekonomike*”, është mbështetja në para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, “*Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore*”, të ndryshuar”, të zëvendësohet me paragrafin “*Ndihmë ekonomike*”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.57/2019, “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
2. Në kapitullin “Referimi mbrojtja dhe asistenca”, faqe 20, “Fëmijët”, paragrafi: “*Punonjësi i rastit i qendrës së emergjencës/strukturës së specializuar për mbrojtje informon NJMF dhe APAP-in e ASHMDF-së. Me marrjen e njoftimit, APAP-i përcjell informacionin tek Sekretariati i AP-së dhe, nëse është e nevojshme, kërkon mbledhjen e menjëhershme të AP për menaxhimin e mëtejshëm të rastit. NJMF/PMF-ja monitoron referimin e rastit*”, sqarojmë se kjo procedurë parashikohet në legjislacionin në fuqi në mënyrë të detajuar, në nenin 56, të Ligjit

Relacion shpjegues për projektvendimin për “Miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

Nr.18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” përcakton marrjen e masës emergjente të mbrojtjes. Ky paragraf të riformulohet si më poshtë vijon: *“Në situatë të rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit, neglizhimit apo çdo forme tjetër dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo të prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku qëndron fëmija nuk është i sigurt për të, PMF-ja inicion procesin për marrjen në mbrojtje të fëmijës dhe vendosjen e masës emergjente të mbrojtjes, duke njoftuar menjëherë drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.***

3. Lidhur me përcaktimin në paragrafin: *“NJMF njofton APAP-in e ASHMDf-së. Me marrjen e njoftimit, APAP-i përcjell informacionin tek Sekretariati i AP-së dhe, nëse është e nevojshme, kërkon mbledhjen e menjëhershme të AP për menaxhimin e mëtejshëm të rastit. NJMF/PMF-ja monitoron referimin e rastit, sugjeron të riformulohet: “Punonjësi i rastit i qendrës së emergjencës/strukturës së specializuar për mbrojtje informon NJMF. NJMF mund të njoftojnë APAP e ASHMDf në raste kur institucionet nuk i përgjigjen gjatë procesit të menaxhimit të rastit. Me marrjen e njoftimit, APAP-i përcjell informacionin tek Sekretariati i AP-së dhe nëse është e nevojshme, kërkon mbledhjen e menjëhershme të AP për të diskutuar në lidhje me vështirësitë e konstatuara në menaxhimin e rastit dhe mos përgjigje nga institucionet përgjegjëse”. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.***
4. Në kapitullin “Vendosja e fëmijës në qendrën e emergjencës”, paragrafi *“Punonjësi i rastit (punonjës social ose psikolog) referon rastin tek NJMF pasi të sigurohet që nevojat bazë të fëmijës janë plotësuar” (faqe 21), bazuar në nenin 51, të ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, të riformulohet si vijon: “Punonjësi i rastit të qendrës mban kontakte të vazhdueshme me NJMF, në lidhje me çdo situatë, që ndikon në mirëqenien zhvillimin apo rrezikon sigurinë e fëmijës. Mban kontakte të vazhdueshme me PMF-në, i cili shërben si menaxher rasti për fëmijën, ndaj të cilit ofrohen shërbimet në kuadër të Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe njofton PMF-në në lidhje me çdo situatë që ndikon në mirëqenien, zhvillimin apo rrezikon sigurinë e fëmijës”. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.***
5. Në kapitullin “Vendosja e fëmijës në qendrën e emergjencës”, paragrafi *“Nëse nga vlerësimi i kryer apo bazuar në kërkesën për rikthim në familje/familje kujdestare nga familjarë apo vetë fëmija, vendoset që fëmija të kthehet në familje apo familjen kujdestare, punonjësi i rastit njofton menjëherë APAP-in e ASHMDf-së dhe NJMF-në. NJMF-ja do të vazhdojë me monitorimin e mëtejshëm të situatës dhe për të parandaluar rikthimin*

*e mundshëm në rrezik trafikimi (faqe 21). Përsa i përket këtij paragrafi, sqarojmë se, procedura për largimin e fëmijës nga institucioni, të jetë në përputhje me nenin 57, të ligjit nr.18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”. Të riformulohet paragrafi si më poshtë vijon: “Në rast se vlerësohet se fëmija është i gatshëm të dalë nga institucioni dhe familja/familja kujdestare është një mjedis i përshtatshëm ku mund të vazhdojë të jetojë fëmija, atëherë mblidhet GTN (ku duhet të marrin pjesë aktorët që e njohin rastin si dhe përfaqësues të qendrës), me qëllim ndryshimin e masës së mbrojtjes. Pas këtij vendimi PMF harton “masën për vendosjen e fëmijës në kujdesje alternative pranë familjes/familjes kujdestare”. Kjo masë miratohet nga Drejtori i Shërbimeve Sociale në bashki dhe dërgohet për miratim në Gjykatë”. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.***

6. Në kapitullin vendosja e fëmijës në strehëz në paragrafin “Menaxheri i rastit njofton APAP-in e ASHMDF-së për organizimin e intervistës formale. APAP-i i ASHMDF-së njofton NJMF dhe punonjësin e policisë për kryerjen e intervistës formale”, (faqe 23), bazuar në nenin 67, të ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, paragrafi të riformulohet si më poshtë vijon: “Menaxheri i rastit brenda në qendër/strehëz njofton NJMF dhe punonjësin e policisë, aty ku fëmija ka vendbanimin për organizimin e intervistës formale. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
7. “Në rast se fëmija është i huaj, menaxheri i rastit nis menjëherë procedurat për sigurimin e lejes së qëndrimit për fëmijën”. Ky paragraf të riformulohet: “Në rast se fëmija është i huaj, menaxheri i rastit në qendër/strehëz nis menjëherë procedurat për sigurimin e lejes së qëndrimit për fëmijën”. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.**
8. Në pikën “Në rast të largimit të fëmijës nga qendra pa leje, menaxheri i rastit njofton menjëherë APAP dhe bën kallëzimin në strukturat vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm në DPQ. APAP-i i ASHMDF-së njofton Sekretariatit e AP. (faqe 23), të riformulohet me këtë përmbajtje: “Në rast të largimit të fëmijës nga qendra pa leje, menaxheri i rastit të qendrës bën kallëzimin në strukturat vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm në DPQ, njofton menjëherë NJMF-në dhe Sekretariatit e AP”. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.**
9. “Në rast të referimit të fëmijës në familje/familjen kujdestare, menaxheri i rastit njofton periodikisht NJMF-në për ecurinë dhe informon APAP”, ky paragraf të riformulohet si vijon: “Në rast të referimit të fëmijës në familje/familjen kujdestare, NJMF-informon periodikisht APAP e ASHMDF-së, në lidhje me monitorimin dhe ecurinë e rastit. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.**

10. Në formularin C3 FORMULAR PRANIMI NË QENDËR EMERGJENCE/STREHËZ PËR FËMIJË [emri i institucionit]nr. prot. tiranë, në paragrafin detyrimet e palëve, ku citohet që “personi ka të drejtë të largohet vullnetarisht në çdo kohë, duke nënshkruar një deklaratë përkatëse”, sugjerojmë që *ky paragraf të hiqet*, pasi referuar nenit 59, të ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, për aq kohë sa vendimi i vendosjes së fëmijës në qendër është marrë nga drejtori i shërbimeve sociale në bashki dhe gjykata edhe dalja e fëmijës nga qendra bëhet nga një masë e marrë nga drejtori i shërbimeve sociale në bashki dhe gjykata. Të mbahet në konsideratë fakti që një fëmijë i moshës 0-18 vjeç, nuk mund të marrë asnjë vendim vetë. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
11. Në Rubrikën III, të Relacionit shpjegues të projektaktit, sugjerojmë që togfjalëshi “...*Ligjit të Përfshirjes Sociale...*”, të zëvendësohet me togfjalëshin “...*Ligjit për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë...*”. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.**
12. Po në këtë rubrikë duhet sqarohet më qartë dhe më saktë paragrafi që përcakton se: *risi e projektvendimit është edhe parashikimi i vendimit për njohjen e statusit të viktimës dhe viktimës së mundshme të trafikimit, duke marrë parasysh faktin që njohja e këtij statusi ka qenë e mundur edhe më parë.* Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.**
13. Bazuar në nenin 3, të ligjit nr. 18/2017, në paragrafin “Përkufizime”, termi “Fëmijë”, të riformulohet me këtë përmbajtje: “Fëmijë”, është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**

Gjatë takimit të Grupit Ndërinstitucional të Punës të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, zhvilluar më datë 02 korrik 2025, u diskutua mbi draft dokumentin dhe anëtarët përcollën komentet si më poshtë:

Organizata World Vision, nëpërmjet email-it, njoftoi se është dakord me draft-in e përcjellë.

Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat e Trafikimit, sugjeron si më poshtë:

- **Përcaktimi i qartë i numrit të indikatorëve** që duhet të përmbushen për të dhënë statusin e viktimës së mundshme të trafikimit (VMT). Numri i indikatorëve duhet të jetë garanci për një proces të drejtë dhe të qartë si dhe për të shmangur të gjithë problematikat e hasura deri me sot. Kjo specifike mund të përfshihet tek veprimet për intervistën formale. Lidhur me këtë

Relacion shpjegues për projektvendimin për “Miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

sugjerim **sqarojmë se** në dokument është përcaktuar në përkufizim se: **“Viktimë e mundshme trafikimi”** (VMT), është personi, për të cilin/të cilën, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar, bazuar në treguesit/indikatorët/dritën e rrethanave të veçanta të rasteve, në të cilën, **të paktën tre ose më shumë elemente** përbëjnë dyshimin e arsyeshëm se personi mund të jetë trafikuar. Pra, është përcaktuar se duhet të evidentohet të paktën tre indikatorë për të dhënë statusin e viktimës së mundshme të trafikimit.

- **Rivlerësimi periodik i statusit të VT/VMT**, në përputhje me praktikat që aplikohen për viktimat e dhunës në familje, pasi statusi i viktimës së trafikimit nuk mund të zgjasë në mënyrë të pacaktuar. Kjo nuk është në interesin e vetë viktimës dhe bie ndesh me parimin që synon të parandalojë riviktimizimin dhe stigmatizimin. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua duke shtuar detyrat e Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional.**
- Në rastet e trafikimit të "fëmijëve për lypje ose krime të vogla", duhet të parashikohet qartë mosha si faktor përcaktues. Në këtë pikë duhet specifikuar përgjegjësia penale. Diferencimi është i domosdoshëm për të siguruar mbrojtje të përshtatur për çdo grupmoshë. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, vetë parashikimi e përcakton se i referohet fëmijëve, pra personave të mitur.**
- Për pikën “Braktisja e fëmijës” si arsye për pranimin në mbrojtje, duhet të sqarohet se qendrat që ofrojnë mbështetje për VT/VMT nuk trajtojnë raste që i përkasin kategorisë së fëmijëve pa kujdes prindëror/ligjor, kjo kërkon ndarje të qartë kompetencash ndërmjet institucioneve. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, listimi i arsyeve të pranimit, është bërë me qëllim evidentimin e indikatorëve.**
- Duhet të përfshihet gjithashtu në dokument, rishikimi i statusit të një VT/VMT që është njëkohësisht me status VT/VMT dhe subjekt i hetimit penal, apo me masë sigurie. Këto situata krijojnë konflikt institucional dhe kërkojnë qartësim në procedura. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, në çdo rast kur personi ka marrë statusin e viktimës (së mundshme) të trafikimit, dhe ndaj tij/saj ka nisur një hetim penal do zbatohet prezumimi i pafajësisë deri në momentin që merr formë të prerë vendimi gjyqësor.** Nëse deklarohet fajtor/e do të zbatohet masa e sigurisë vendosur me vendim gjyqësor.
- Disa Indikatorë aktualë shpesh janë të paqartë dhe të përgjithshëm. Për shembull, fraza si “reklama që ofrojnë shërbime të grave të një etnie” ose “prania e rrobave të vogla për fëmijë”, “lëvizja nga një bordell në tjetrin”, “hanë të ndarë nga anëtarët e familjes” duhet të shoqërohen me kontekst dhe udhëzime më specifike për interpretim, në mënyrë që të shmanget keqkuptimi ose nënvlerësimi i rasteve reale. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, në hartimin e këtij dokumenti fokusi ka qenë evidentimi shterues i indikatorëve/treguesve parësorë/dytësorë (evident/tërthorazi tipikisht të**

dukshëm), në mënyrë që të ofrohet mbrojtje gjithëpërfshirëse për çdo rast të mundshëm trafikimi. Gjithashtu, pas miratimit të këtij dokumenti do të hartohet një udhëzues i detajuar, për të zbatuar në mënyrë sa më të detajuar procedurat.

- Sugjeron, përfshirjen e një institucioni të tretë si psh SHSSH, në intervistimin formal të fëmijës, kjo për të evituar problematikat si dhe për të qartësuar procesin. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se këto procedura janë hartuar nga GNP (ku ka edhe përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror), të cilët bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore e tyre kanë dakordësuar draftin me detyrat ashtu sikurse janë përcaktuar.**
- Referimi i fëmijës në institucion, duhet të shoqërohet përpos të gjithë dokumenteve të tjerë edhe me një plan riintegrimi afatgjatë nga NJMF-të. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, Qeveria Shqiptare, përpos financimit nga Buxheti i Shtetit për zërin “Fonde për Ushqim për VT/VMT”, mundëson pagat e punonjësve social të qendrave joshitetërore (përfshirë edhe QKPVT si një entitet shtetëror), të cilët kanë detyrë funksionale edhe hartimin e planeve individuale afatgjata për vt/vmt. NJMF-të, në çdo rast bashkëpunojnë me qendrat për ofrimin e mbështetjes dhe hartimin e planeve të mbrojtjes.**

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, nëpërmjet email-it të dërguar më datë 09.07.2025, sugjeron si vijon:

- Tek përkufizimi i masës emergjente të mbrojtjes, të shtohet fjala “fëmijë”, duke përcaktuar si referencë ligjin nr. 18/2017. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të shtohet përkufizimi i menaxherit të rastit për fëmijët, duke përcaktuar se është në çdo rast PMF. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të shtohet përkufizimi i shërbimit të emergjencës për fëmijë. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, referuar legjislacionin në fuqi (ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror " neni 18-19-20) përcakton qartë rastet të cilat trajtohen me strehimin të përkohshëm, përfshirë edhe qendrat e emergjencës dhe afatet kohore.**
- Të shtohen/theksohen shërbime psiko-sociale të ofruara nga institucionet përgjegjëse shtetërore dhe jo shtetërore për identifikimin fillestar. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Treguesi i trafikimit për fëmijë “Udhëtojnë të pashoqëruar nga të rriturit”, të parashikojë udhëtimet brenda dhe jashtë vendit. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se treguesi u riformulua si vijon: “Udhëtojnë**

brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të pashoqëruar nga të rriturit”.

- Indikatori “*Rastet e adoptimeve të paligjshme*”, në faqen 11 të riformulohet si vijon: “*Kur fëmija qendron në kujdesin e njerëzve që nuk kanë lidhje gjaku ose kujdestari të formalizuar*”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Fjala “grave” Indikatori “*Reklama që ofrojnë shërbime të grave të një etnie ose kombësie të veçantë*” në faqen 13, të zëvendësohet me fjalën “fëmijëve”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Në faqen 15, pika 3, sugjeron që në rastet kur përmendet PMF, të specifikohet dhe termi fëmijë. Lidhur me këtë sugjerim **sqarojmë se, u reflektua.**
- Duhet të parashikohet mundësia e ankimit të vendimit nga kujdestarët ligjorë në rastet e të miturve. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të specifikohet nëse menaxheri i rastit, si person i tretë që mund të marrë pjesë në intervistën formale, është i ndryshëm nga PMF-ja apo punonjësi i caktuar në shërbimin ku është akomoduar fëmija. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u shtua punonjësi i rastit dhe menaxheri i rastit sipas përkufizimit të shtuar do të jetë PMF-ja.**
- Lidhur me të drejtën për ankim sugjeron të parashikohen rastet kur është fëmijë që nuk është njohur si VT/ VMT dhe prindi / kujdestari ligjor / pmf /punonjësi i shërbimit ku është akomoduar fëmija kanë mendim ndryshe dhe dëshirojnë të ankimojnë vendimin e marrë nga grupi i identifikimit. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, ankimi mund të depozitohet në çdo rast nga përfaqësuesi/kujdestari ligjor.**
- Sugjeron të mbahet në konsideratë fakti që prindi mund të mos ndodhet me fëmijën në shërbimin e emergjencës. Kryesisht komunikimet mbi vendimmarrjen i takon PMF për t’ia komunikuar fëmijës, megjithatë punonjësi i qendrës mund të lehtësojë procesin. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u riformulua parashikimi.**
- Referuar rasteve kur fëmija është i huaj, duhet të merret në konsideratë nëse është i shoqëruar me prindërit apo jo. Qendra e emergjencës nuk merr dot statusin e kujdestarit pasi nuk është shërbim rezidencial dhe stafi i qendrës mund të asistojë por aplikimin për kërkimin e azilit e ka si autoritet kujdestari ose PMF deri në përcaktimin e kujdestarit. Çfarë ndodh në rast se fëmija pavarësisht se ka elementet apo identifikohet si VT/VMT dhe është mbi 14 vjeç, nuk dëshiron të aplikojë për azil apo leje qëndrimi. Kryesisht të miturit e huaj të pashoqëruar e përdorin Shqipërinë si vend

tranzit dhe nuk dëshirojnë të qëndrojnë këtu. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u saktësua se procedura e marrjes së lejes së qëndrimit realizohet nga PMF me asistencën e stafit të qendrës.** Në çdo rast PMF së bashku me stafin e qendrës në bazë të vlerësimit iniciojnë procedurën e azilit/lejes së qëndrimit duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës dhe me synimin për të marrë shërbimet e nevojshme (shëndetësore, arsimore etj.)

- Duhet specifikuar nëse qendrat e emergjencës mund të akomodojnë nena me fëmijë, apo edhe fëmijë të pashoqëruar. Për fëmijët që merren në mbrojtje dhe zhvendosen nga mjedisi familjar, PMF-ja e merr fëmijën dhe e vendos në shërbim emergjence pa familjare. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, raste kur vendoset kjo masë përcaktohen në ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” neni 56 “ Masa emergjente e mbrojtjes”.**
- Duhet të përcaktohen afatet kohore që mund të përfshijë shërbimi i emergjencës, 72 ore, 30 ditore, etj. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, legjislacionin në fuqi (ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" neni 18-19-20) përcakton qartë rastet të cilat trajtohen me strehimin të përkohshëm, përfshirë edhe qendrat e emergjencës dhe afatet kohore.**
- Duhet specifikuar se si fëmija/familja bie në kontakt me shërbimin e emergjencës. Pra është struktura e PMF/NJMF që e shoqëron fëmijën në shërbim apo vetë policia. Pasi kryhet shoqërimi dhe dorëzimi i fëmijës nga strukturat përgjegjëse, që në raste specifike mund të shoqërohet edhe nga prindi, atëherë stafi i shërbimit vijon me zbatimin e standardeve të shërbimit. Shërbimi i emergjencës ka PSV e miratuara, ku që në dokumentin hyrës përcaktohet struktura referuese dhe kush e ka shoqëruar fëmijën në qendër. Njësoj edhe për futjen në strehëz. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, bazuar në procesin e identifikimit fillestar, janë përcaktuar personat/strukturat përgjegjës për identifikimin dhe referimin e rastit, bazuar në nevojat.**
- Lidhur me rastin kur fëmija është i huaj i pashoqëruar, sugjeron një interpretim më të zgjeruar. **Sqarojmë se, parashikimi u riformulua.**
- Sugjeron të specifikohen procedurat e futjes së fëmijës në strehëz, shoqërimi, transporti, kur fëmija shkon nga shërbimi i emergjencës ose shërbim tjetër shoqëror në strehëz; kur fëmija shkon nga familja në strehëz. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, këto procedura do të sqarohen me udhëzimin që do të hartohet pas miratimit të këtij dokumenti.**
- Sa i përket realizimit të intervistës formale, sugjeron marrjen në konsideratë të faktit nëse intervista formale është kryer gjatë kohës që ka

qenë në shërbim emergjence ose në familje/ tjetër. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, bazuar në parashikimet e këtij dokumenti është përcaktuar edhe procesi i realizimit të intervistës formale.**

- Duhet parashikuar nëse kujdestari ligjor pra prindërit mund të jenë abuzuesit/ në mungesë të kujdestarit ligjor mund të jetë PMF ose drejtuesit e qendrës ku ndodhet fëmija. Shërbimet e kujdesit shëndetësor mund të ofrohen edhe mbi bazën e marrëveshjes që qendra/ strehëza ka me qendrën shëndetësore më të afërt. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u riformulua.**
- Sa i përket kthimit vullnetar të asistuar, për fëmijët, të rishikohet parashikimi duke specifikuar detyrat e ASHMDF-së. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, të gjitha raste e kthimeve vullnetare të asistuara, ndërmjetësohen nga Autoriteti Përgjegjës, anëtar i të cilit është edhe përfaqësuesi i ASHMDF-së dhe pjesë e procesit të kthimit vullnetar të asistuar.**
- Sugjeron që afati kohor i monitorimit të riintegrimin nga Autoriteti Përgjegjës duhet të jetë të paktën 2 vjet. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të përcaktohen afatet e rishikimit të planit. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, rishikimi i planeve të riintegritit vlerësohet rast pas rasti nga strukturat përgjegjëse.**

Qendra Psikosocial “VATRA”, nëpërmjet email-it të dërguar më datë 10.07.2025, sugjeron si vijon:

- Të shtohet si tregues trafikimi “*Të jenë të detyruar të ndajnë të ardhurat me të tjerët*”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të shtohet si tregues trafikimi “*Të shfaqin elementë të vulnerabilitetit në të kaluarën (dhunë në familje, abuzim/ngacim seksual, braktisje të shkollës, etj).*”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.** Të shtohet tek treguesi “*Duken të frikësuar dhe të sillen në një mënyrë që nuk përputhet me sjelljen tipike të fëmijëve të moshës së tyre*”, fjalia “*Mund të refuzojnë ndihmën*”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të shtohet treguesi trafikimi për fëmijë si vijon “*Shoqërohen nga persona palidhje gjaku në frekuentimin e ambienteve të papërshtatshme për moshën: hotele, lokale nate*”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të shtohet si tregues trafikimi për qëllime të shfrytëzimit seksual “*Jenë pjesë e portaleve/reklamave/rrjeteve online të shfrytëzimit*”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**

- Lidhur me sugjerimin që tek treguesit e trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë, të shtohet: *Mund të mos kenë akses në mjetet e identifikimit. Kërcënohen se do të kthehen në vendin e origjinës nëse nuk pranojnë kushtet e punës. Raportojnë forma të tjera të dhunës: kërcënime, presion psikologjik, dhunë fizike dhe/ose ngacmim seksual. Mos kenë akses te shërbimi mjekësor, sqarojmë se, këto tregues janë listuar në treguesit e përgjithshëm.*
- Të përcaktohet nëse menaxheri i rastit për fëmijët është gjithmonë PMF apo në intervistë mund të jetë i pranishëm edhe menaxheri i rastit i një qendre ku fëmija merr/do të marr shërbime. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u shtua përkufizimi i menaxheri të rastit dhe është sqaruar.**
- Të bëhet një shpjegim më i zgjeruar i masave të mbrojtjes dhe kujdestarisë duke qënë se qendrat (e emergjencës dhe strehëzat për VT/VMT) nuk marrin statusin e kujdestarit. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u riformulua.**
- Të specifikohet që procesin e vendosjes së fëmijës në strehëz e ndjek dhe e realizon PMF. Edhe shoqërimin, transportin dhe dorëzimin e fëmijës. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të saktësohet tek “Vendosja e të rriturit në qendrën e emergjencës”, se informimi për rregullat e qendrës/strehëzës dhe programin e rehabilitimit realizohet përpara akomodimit të rastit në strehëz. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të specifikohet që për rastet VT/VMT të akomoduara në strehëz, shërbimi mjekësor mund të ofrohet në qendrën më të afërt shëndetësore. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të ketë përcaktime më konkrete se kush do të ndjekë përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin në institucionin arsimor. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Sa i përket Kthimit Vullnetar të Asistuar, sugjerohet që institucionet e shëndetësisë, arsimit dhe shërbimi i mbrojtjes së fëmijës (PMF) të vendosen të ndara. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**
- Të specifikohet se, në rastet e fëmijëve, ASHMDF, PMF dhe qendra nisin procedurën për vlerësimin e familjes dhe riskut. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, të gjitha raste e kthimeve vullnetare të asistuara, ndërmjetësohen nga Autoriteti Përgjegjës, anëtar i të cilit është edhe përfaqësuesi i ASHMDF-së dhe pjesë e procesit të kthimit vullnetar të asistuar.**
- Lidhur me komentet mbi përmbajtjen e formularëve, **sqarojmë se, u**

reflektuan.

Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”, nëpërmjet email-it ka sugjeruar si më poshtë:

- Tek përkufizimet “Kallëzimi” i viktimës nëse ka elementë penal duhet të ndiqet kryesisht nga policia. Lidhur me këtë koment, **sqarojmë se, përkufizimi është marrë nga legjislacioni penal.**
- Termi bordel, të zëvendësohet me fjalën “vend”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u riformulua.**
- Të bëhet edhe një parashikim për ankimin e personave që i përkasin një komunitetit të caktuar Rom, Egjiptian, janë me aftësi të kufizuar, nuk dinë të shkruajnë apo shtetasit e huaj, **sqarojmë se në çdo rast është parashikuar e drejta për ankim nga përfaqësuesi/kujdestari ligjor.**
- Të përcaktohet që raportimi mbi ecurinë e planit të riintegrit të bëhet 1 herë në muaj për çdo rast. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua duke përcaktuar se raportimi do të bëhet 1 herë në 3 muaj për të evidentuar më saktë ecurinë.**
- Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre: b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal. A kanë ofruesit e ndihmës juridike parësore(Qendra e Ndihmës Juridike Parësore/OJF (përveç D&E dhe VATRA)) ekspertizë për garantimin e të drejtave procedurale të viktimës së trafikimit? Lidhur me këtë koment **sqarojmë se, për të garantuar cilësinë e këtij shërbimi dhe për të përmbushur detyrimin ligjor, nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë ndërmarrë masa konkrete duke përfshirë trajnime të vazhdueshme për stafin e qendrave dhe organizatave jofitimprurëse, me fokus në mënyrën e identifikimit, pritjes dhe trajtimit të kategorive të veçanta, ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit.** Gjithashtu, në bashkëpunim me OSBE-në, të gjithë punonjësve u është vënë në dispozicion një manual praktik mbi komunikimin dhe ndërveprimin me kategoritë e veçanta. Në rastet kur lind nevoja për ofrimin e shërbimeve më të specializuara, rastet referohen pranë VATRA-s dhe "Të ndryshëm dhe të barabartë", që disponojnë kapacitete të integruara për mbështetjen e kësaj kategorie.
- Mungon formati i njoftimit të Autoritetit Përgjegjës për çdo rast të identifikuar dhe referuar në programet e organizatave. Lidhur me këtë koment, **sqarojmë se, Autoriteti Përgjegjës njoftohen nga personat/strukturat përgjegjëse, nëpërmjet formateve për identifikimin fillestar dhe formal.**

Projektvendimi së bashku me praktikën shoqëruese u dërgua për bashkërendim pranë ministrive të linjës.

Ministria e Financave, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord, për sa kohë që efektet financiare të projektvendimit do të përballohen brenda tavaneve buxhetore të miratuara për institucionet e ngarkuara me zbatimin e tij.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet dakord.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet parimisht dakord.

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet sistemit E-Akte shprehet me komentet si vijon:

- Në Kreun VII të relacionit shpjegues është parashikuar se procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit janë hartuar në dritën e Direktivës 1712/2024 e cila ndryshon Direktivën 2011/36/BE, ndërkohë që në Kreun V të relacionit përcaktohet se projektvendimi nuk synon përafrim me acquis të Bashkimit Evropian. Sa më sipër, sugjerojmë që të jepen sqarimet përkatëse dhe në rast se akti synon përafrim me direktivën e sipërcituar të mbahet në konsideratë Kreu IV i vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar. Konkretisht, sugjerojmë që bashkëlidhur projektvendimit të jetë edhe tabela e përputhshmërisë. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, nga ana jonë u përgatit tabela e përputhshmërisë me Direktivën EU/36/2011, e ndryshuar nga Direktiva 1712/2024, për parashikimet lidhur me identifikimin, mbrojtjen dhe asistencën ndaj viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.**
- Lidhur me procedurën e ankimimit pranë Komisionit të Posaçëm Ndërinstitucional, sugjerojmë që parashikimet mbi afatin 5 ditor për paraqitjen e ankimit kundër vendimit të marrë nga grupi i identifikimit formal, si dhe afati maksimal 15 ditë pune për marrjen e vendimit administrativ nga Komisioni i Posaçëm, të rishikohet në përputhje me afatet e përcaktuara në nenet 132 dhe 140 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**

- Në Kreun IV, të relacionit shpjegues, sugjeron heqjen e paragrafit të parë, pasi nuk është në përputhje me bazën ligjore që shërben për miratimin e këtij projektvendimi. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se, u reflektua.**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet shkresës nr. 2480/3 prot., datë 20.08.2025 shprehet parimisht dakord.

Projektvendimi së bashku me praktikën shoqëruese u dërgua për bashkërendim pranë **Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator**, i cili nëpërmjet E-akte është shprehur dakord me miratimin e projektvendimit, por konstaton se nenet e mëposhtme nuk pasqyrojnë përafrim të plotë me nenet përkatëse të direktives por të pjesshëm. Konkretisht:

- Neni 11, pika 3, i Direktivës nuk i referohet vetëm “dëshmisë në gjykatë”, por gjithashtu parashikon bashkëpunimin në fazën e hetimit dhe ndjekjes penale (pra, përpara gjyqimit). Pika 2 e projektvendimit nuk e përcakton qartë që dhënia e ndihmës nuk kushtëzohet nga bashkëpunimi me policinë/prokurorinë në fazën fillestare të hetimit, por e kufizon formulimin vetëm te “dëshmuar në gjykatë”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se** në tabelën e përputhshmërisë u saktësua përafrimi nga “i plotë”, në “i pjesshëm”.
- Neni 11, pika 7 i Direktivës krijon paqartësi. Është e nevojshme të riformulohet saktë pasi nuk kufizohet vetëm te parimi i mosdiskriminimit, ai kërkon që viktimave me nevoja të veçanta (p.sh grave shtatzëna, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës së rëndë) t’u ofrohet kujdes i posaçëm, i përshtatur sipas nevojave të tyre specifike. Teksti i pikës 8 të projektvendimit nuk përmban referenca për trajtim të diferencuar apo mbështetje të personalizuar për gratë shtatzëna, për personat me çrregullime psikologjike, etj. Ai parashikon vetëm trajtim “pa diskriminim”. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se** nga ana jonë u riformulua pika 8.
- Në praktikën e përcjellë për shqyrtim duhet të përfshihet edhe drafti në gjuhën angleze. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se** praktika do të përcillet e plotë sipas kërkesës.

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet E-akte është shprehur dakord me miratimin e projektvendimit duke sugjeruar që në fund të faqes së parë të dokumentit, të bëhet shënimi fundor mbi datë e miratimit dhe titullin e plotë të instrumentit ligjor të acquis të BE-së, me të cilin është përafruar projektakti, përfshirë numrin CELEX dhe atë natyror. Lidhur me këtë sugjerim, **sqarojmë se** u reflektua.

Më datë 13-14 nëntor 2025, u zhvillua Seminari Ndërinstitucional mbi Forcimin e Kornizës Rregullatore në luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore,

organizuar në kuadër të programit EU4FAST. Qëllimi i seminarit ishte diskutimi mbi sfidat dhe praktikat më të mira, si dhe identifikimi i rekomandime të qarta për të forcuar kuadrin rregullator për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri. Rekomandimi i përcjell, në përfundim të seminarit, ishte përfshirja në draft-in e Procedurave Standarde të Veprimit të parashikimit mbi pikën fokale për referimin ndërkufitar të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit (neni. 11/4 i Direktives 2011/36/EU, ndryshuar me Direktivën 2024/1712).

Ky parashikim u reflektua në faqen nr. 29 “KTHIMI VULLNETAR I ASISTUAR”.

Projektvendimi së bashku me praktikën shoqëruese u ridërgua për dakordësim pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit angazhon të gjithë institucionet përgjegjëse të sigurojnë zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë dokument, në përputhje me fushën e kompetencës dhe përgjegjësisë, duke përfshirë edhe sigurimin e burimeve të nevojshme. Për zbatimin e këtyre procedurave, aktivitetet dhe masat përkatëse do të planifikohen dhe buxhetohen nga çdo ministri apo strukturë, në Programet Buxhetore Afatmesme (PBA) përkatëse.

MINISTRI

ALBANA KOÇIU

